



**Shoqata Forumi i Gruas – Tetovë**  
punon në drejtim të:

- ✦ **Informimit** dhe njëkohësisht të ngritjes së vetëdijes së grave për përfshirjen e tyre të pamjaftueshme në procese ku sjellen vendime si pasojë e vlerave patriarkale, me çrast gruas i caktohet vëndi në shtëpi dhe jo në jetën publike.
- ✦ **Ngritjes** së vetëdijes tek gratë për ekzistimin e jo barazisë gjinore, si dhe për kufizimin në qasjen e tyre në shërbime sociale të cilat janë të limituara sidomos për gratë nga viset rurale.
- ✦ **Implementimit** të projekteve për trajnim të grave nga shtresat më të ndjeshme sociale, gratë nga viset rurale me nivel të ulët arsimor; si dhe aplikon në projekte ku përmes programeve të ndryshme do të ndikohet në zvogëlimin e papunësisë së grave të marginalizuara.

Shoqata Forumi i Gruas – Tetovë është organizatë joqeveritare e cila jep shërbime grave mes **Qendrës për ndihmë juridike e cila ofron shërbime pa pagesë për viktimat nga dhuna në familje si: Këshilla juridike, dërgim në institucione përkatëse shtetërore, ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje dhe përfaqësim para gjyqit.**

**Përmes QNJ trajtohen:** Marrëdhëniet pronësore juridike, marrëdhëniet trashëguese, mbrojtja penale juridike, ndihmë sociale (këshilla dhe referime).

**Sferat e punës së QNJ janë:** Marrëdhëniet martesore (shkurorëzim martese), përkujdesje, alimentacion.



## Kompetencat e Qendrës për Punë Sociale në raste të dhunës në familje

- ✦ Viktima bisedon me punëtorin social për atë që ka ndodhur dhe ka të drejtë të kërkojë procesverbalin
- ✦ Viktima ka të drejtë të kërkojë nga personi profesional të njoftohet me të drejtat që i takojnë me ligj
- ✦ QPS ka për detyrë të njoftojë viktimën edhe me mundësitë e vendosjes në strehimore si dhe me mundësitë për përkujdesje
- ✦ QPS ka për detyrë viktimave të ju mundësojë ndihmë psiko-sociale
- ✦ Punëtori social është i detyruar të bisedojë me viktimën për parashtrimin e kërkesës për shqiptimin e masave të përkohshme për mbrojtje deri tek organet kompetente

☎ 044 34 34 10

info@forumi.org.mk

www.forumi.org.mk

☎ 044 331 575

☎ 044 339 140

Adresa: Rr. 121, nr. 2

# Ministria e Punëve të Brendshme (P o l i c i a)

## Komuna e Tetovës

Kompetencat e Policisë  
në rastet e dhunës në familje janë:

 **192**

- ↗ Detyrë e Policisë është të mbrojnë viktimën dhe të zbulojë kryerësin e dhunës.
- ↗ Nëpunësi i Policisë duhet të jetë i kujdesshëm dhe deri në fund të dëgjojë kronologjinë e ngjarjes duke treguar kuptim për gjendjen me të cilën ndihet viktimja.
- ↗ Bisedohet ndaras me viktimën dhe dhunuesin duke vërtetuar faktin a ka nevojë për mjekim.
- ↗ Për masat e ndërmarra menjëherë ose më së voni pas 48 orëve nëpunësi policor duhet të informojë me shkrim Qendrën për punë sociale.
- ↗ Po që se ka elemente për përgjegjësi penale nëpunësi policor ka për detyrë të parashtorojë padi penale kundër kryerësit të veprës

Sektori për Punë të Brendshme – Tetovë

 044 334 220  044 334 604

 044 334 737  044 331 107

Stacioni policor

 044 334 460  044 334 220

Komuna e Tetovës:

- ↗ Komuna është e obliguar qytetarëve të iu sigurojë qasje në informata për shërbimet që ndërmerr si dhe për punën e Këshillit dhe KMB mes burrave dhe grave.
- ↗ Komuna planifikon zhvillimin e ekonomisë lokale, me ç'rast mbështet zhvillimin e sipërmarrësisë së grave në nivel lokal.
- ↗ Komuna bën përpjekje të investojë në infrastrukturë duke përmirësuar sidomos në viset rurale shërbimet e transportit si dhe sistemin energjetik dhe telekomunikativ.
- ↗ Në aspekt të kujdesit social dhe mbrojtjes së fëmijëve, komuna mbështet financimin, mirëmbajtjen e çerdheve dhe shtëpive për të moshuarit.
- ↗ Komuna tenton të mbështes OJQ-të në implementimin e projekteve që kanë të bëjnë me aftësimin e qytetarëve për programe të ndryshme.

 044 511 930

 044/339-240

Adresa: Rr. Dervish Cara pn.  
info@tetova.gov.mk

**Kur keni nevojë për  
ndihmë kërkoni  
institucionet e  
lartëpërmendura**

- ↗ Problem me të cilin ballafaqohet komuna është papunësia e lartë e grave sidomos në viset rurale me çrast sektori për zhvillim ekonomik lokal në nivel komunal përmban masa për fuqizim ekonomik të gruas, por në të shumtën e rasteve nuk janë siguruar mjete financiare për implementim.
- ↗ Punësime të qëndrueshme të grave janë inicuar në kuadër të projekteve të financuara nga ndihma për zhvillim.